



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2944/4 Prot.

Tiranë, më 12.12.2025

VENDIM

Nr. 67 Datë 12.12 2025

**“PËR
NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 51
DATË 14.11. 2022 "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR POZICIONET E
PUNËS NË ADMINISTRATË" NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, gërma f, neni 67, pika 3, në Statutin e UST-së, kreu V, neni 66, pika 1, pika 5; në Rregulloren e UST-së neni 41 "Personeli Administrativ", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 27, datë 21.05.2021 "Për miratimin e rregullores së rekrutimit të personelit administrativ në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.08, datë 29.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 51, datë 14.11.2022 "Për miratimin e kriterëve për pozicionet e punës në administratë", në relacionin e administratorit nr 2918 prot, datë 05.12.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 12.12.2025,

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e kriterëve për pozicionet e punës "Specialist/e" në Sektorin e Prokurimeve pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, të Vendimit të BA nr 51 datë 14.11.2022 si më poshtë:

Ndryshim në kriteret e përgjithshme, pika 1:

Ishte

- Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës në shkenca ekonomike.

Bëhet

- Diplomimi në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.

Ndryshim në kriteret e veçanta, pika 1:

Ishte

- Të ketë diplomë të nivelit "Bachelor" dhe "Master Profesional" ose DIND në shkenca ekonomike.

Bëhet

- Të ketë diplomë të nivelit "Bachelor" dhe "Master Profesional" ose DIND në shkenca ekonomike/juridike/inxhinierike.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

